

qershor 2024

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin maj

2024

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin maj

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, qershor 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit maj 2024, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i 23-të mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese




Bazuar në monitorimin dhe trajtimin e 73 përmbajtjeve keqinformuese gjatë muajit maj 2024, është evidentuar se përmbajtjet mashtruese dhe dezinformatat kanë qenë dy kategoritë kryesore të keqinformimit, secila me nga 19%. Këto kategori pasohen nga përmbajtjet e paverifikuara me 16%, clickbait me 12%, teoritë konspirative me 10% dhe lajmet e rreme me 10%.

Ashtu si në muajin paraprak, kur kishte dominuar dezinformata si kategori e keqinformimit, edhe gjatë këtij muaji përmbajtjet dezinformuese kanë dominuar përkundër faktit që kanë pësuar një rënie të lehtë. Përmbajtjet mashtruese, që në muajin paraprak radhiteshin në vend të tretë si kategori vlerësuese me 16%, në këtë muaj (maj) më një rritje prej 3% bashkëndajnë pozitën e parë me 19% sa i përket kategorive vlerësuese. Kjo ka rezultuar për faktin se ka pasur një shumësi të temave nga fusha e politikës dhe sociale që janë vlerësuar si dezinformatë apo mashtrim.

Këto dy kategori pasohen nga përmbajtjet e paverifikuara me 16%, të cilat kanë pësuar rënie krahasuar me muajin prill, kur radhiteshin në vend të dytë (nga 22% në muajin prill 2024, në 16% në muajin maj 2024). Pothuajse të gjitha këto përmbajtje të paverifikuara janë publikuar në media sociale. Bëhet fjalë kryesisht për temat nga fusha e sigurisë.

Përmbajtjet e paverifikuara pasohen nga artikujt clickbait në përqindje të njëjtë sikur në muajin e kaluar dhe teoritë konspirative të cilat kanë shënuar një rritje prej 4% krahasuar me muajin prill (nga 6% në muajin prill 2024, në 10% në muajin maj 2024).



38% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “mashtrim” dhe “dezinformatë”

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1.1

01. Mashtrim

Pothuajse të gjitha përmbajtjet mashtruese janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale (Facebook, TikTok). Fushat dominuese në të cilat janë publikuar përmbajtjet mashtruese janë socialja (11%) dhe politika (5%). Tri temat kryesore mbi të cilat u publikuan përmbajtjet mashtruese ndërlidheshin me publikimin e produkteve me pretendimin se shërojnë sëmundje të ndryshme, si dhe publikime në media sociale me pretendimin për dhënie kredish si dhe konfliktin Izrael-Hamas. Nuk munguan as tema tjera, si ndihmë financiare për shërim, lojë shpërblyese, mundësi punësimi etj.

03. Përmbajtje e paverifikuara

Përmbajtjet e paverifikuara u publikuan kryesisht nga faqe dhe llogari në media sociale, duke përfshirë edhe dy publikime në media reale. Përmbajtjet e paverifikuara të publikuara në media reale kishin të bënin me pretendimin se një pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) ka mbetur i plagosur nga një mjet shpërthyes, si dhe pretendimi për shkarkimin e Zëvendës Ndhmës Sekretarit të shtetit amerikan, Gabriel Escobarit, i mohuar nga Departamenti i Shtetit (DASH). Ndërsa, në media sociale u publikuan përmbajtje të paverifikuara lidhur me armatosjen e FSK-së, veriun, numrin total të shqiptarëve në botë etj.

02. Dezinformatë

Dezinformatat janë publikuar në media sociale (14%) dhe media reale (5%) në gjuhën shqipe dhe serbe. Këto përmbajtje dezinformuese kryesisht u publikuan nga fusha e politikës, sigurisë dhe sociale. Në mediat në gjuhën serbe u publikuan dezinformatat me pretendim të rremë se Edi Rama ka mbajtur tubim në Greqi pa pëlqimin e autoriteteve greke, si dhe dezinformimin ku përmes një imazhi u pretendua se Savo Manojloviq, kandidat për kryetar në zgjedhjet e ardhshme lokale në Beograd ishte fotografuar në vitin 2015, e se gruaja që shihet krahu është nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Saranda Bogujevci. Ndërsa në përmbajtjet dezinformuese në gjuhën shqipe të publikuara në media reale dhe media sociale, u përfshinë tema si, çmimi i bukës, armatosja e Policisë së Kosovës, masat e BE-së ndaj Kosovës, Kosova dhe KiE etj.

04. Clickbait

Pothuajse të gjitha përmbajtjet “clickbait” janë publikuar në media reale ku dominojnë fusha e kronikës së zezë dhe politika. Përmbajtjet nga kronika e zezë kishin të bënin me ngjarje tragjike, për të cilat në titull nuk bëhet e ditur vendndodhja e ngjarjes përkundër faktit që nuk kishin ndodhur në Kosovë. Clickbait u vlerësuan edhe disa artikuj ndërlidhur me regjistrimin e popullsisë, opozitën politike, asociacionin e komunave me shumicë serbe, ku u përdorën tituj çorientues.

05. Teori konspirative

Teoritë konspirative janë publikuar kryesisht nga mediat në gjuhën serbe ndërlidhur me incidentet në vendbanimet me shumicë serbe në Kosovë dhe temat të tjera. Duke iu referuar komunikatave të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, disa ngjarje në vendbanimet serbe janë interpretuar pa fakte si të motivuara etnikisht. Po ashtu, në media janë publikuar edhe pretendimet e pabaza se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ia ka ofruar Vatikanit tempujt serbë (kishat ortodokse) në Kosovë, si dhe pretendimi i zëvendëskryeministrit të Serbisë, Aleksandar Vulin i cili e ndërlidh pa fakte “Shqipërinë e Madhe” me idenë e pranimit të Kosovës në KiE.

06. Lajm i rremë

Të gjitha lajmet e rreme janë publikuar në media sociale nga fusha e sigurisë, sociale dhe politikës. Lajme të rreme u publikuan për armatosjen e FSK-së me pajisje ushtarake të artilerisë së rëndë, çmimin e bukës, shërimin e sëmundjeve etj.


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: manipulim i fakteve, gabim, dezinformatë/clickbait dhe clickbait/dezinformatë.

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

2

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Pas zyrtarizmit të blerjes së dronëve “Bayraktar” nga Turqia, në media sociale kanë filluar të qarkullojnë spekulime të ndryshme për furnizime me armatime të tjera, përfshirë këtu edhe artileri të rëndë (helikopterë, tanke, aeroplanë). Publikimi i keqinformatave lidhur me pretendime të pabaza për furnizim me armatim të FSK-së, ka bërë që kjo temë të dominojë gjatë muajit maj në kategorizimin e temave për të cilat u keqinformua.

Ndërkaq, konflikti Izrael-Hamas i nisur më 7 tetor të vitit të kaluar (2023) vazhdon të përdoret si temë për keqinformim. Edhe gjatë këtij muaji janë publikuar disa përmbajtje të paverifikuara dhe dezinformata lidhur me konfliktin, duke e bërë këtë temë të radhitet si e dyta për nga numri i keqinformimeve.

Disa incidente të ndodhura në vendbanimet me shumicë serbe në Kosovë gjatë muajit maj u përdoren nga kanale të caktuara për të krijuar teori konspirative për kryerësit dhe qëllimet e veprës, pa ofruar fakte.

Në kuadër të përmbajtjeve keqinformuese të gjetura gjatë këtij muaji, janë trajtuar edhe keqinformata lidhur me raste tragjike (vdekje e vrasje), çmimin e bukës dhe përmbajtje ndërlidhur me Kosovën dhe KiE.



27% e temave kryesore janë për armatosjen e FSK-së, konfliktin Izrael-Hamas, vendbanimet me shumicë serbe, rastet tragjike, çmimin e bukës dhe Kosovën ndërlidhur me KiE.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Armatosja e FSK-së

Lajme të rreme u vlerësuan pretendimet se Turqia i ka dhuruar FSK-së 10 helikopterë luftarakë “Apache”, dhe se Italia i ka ofruar FSK-së helikopterë për blerje. Përmbajtje e paverifikuar u vlerësuan pretendimet se FSK-ja është furnizuar me 33 automjete “BMC Vuran” dhe pajisje të tjera ushtarake.

03. Vendbanimet me shumicë serbe

Përmbajtjet keqinformuese që ndërlidhen me disa incidente në vendbanimet me shumicë serbe në Kosovë janë publikuar në media reale dhe media sociale në gjuhën serbe duke iu referuar komunikatave të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë dhe shefit të saj, Petar Petković. Këto përmbajtje nga fusha e sigurisë janë vlerësuar si teori konspirative për faktin se Zyra dhe shefi i saj, incidentet e ndodhura në vendbanimet me shumicë serbe, përkundër faktin që nuk dihet qëllimi dhe kryerësit e veprës, i interpreton pa fakte si qëllim për spastrim etnik të serbëve.

02. Konflikti Izrael-Hamas

Keqinformatat ndërlidhur me konfliktin Izrael-Hamas janë publikuar nga faqe në Facebook dhe llogari në TikTok. Këto keqinformata ishin nga fusha e sigurisë dhe politikës të cilat u vlerësuan si mashtrim, manipulim i fakteve dhe përmbajtje e paverifikuar. Mashtrim janë vlerësuar përmbajtjet e publikuara në media sociale me pretendimet se aktori, Mel Gibson ka folur për Izraelin, si dhe fotografitë e gjeneruara me inteligjencë artificiale ku shihen disa ushtarë mbajnë flamurin kombëtar shqiptar pranë atij izraelit. Përmbajtje e paverifikuar janë vlerësuar fotografitë e publikuara me pretendimin se paraqesin bombardimet që po ndodhin aktualisht në Rafah në Rripin e Gazës. Ndërsa, manipulim i fakteve është vlerësuar deklaratat e kryeministrit Rama teksa shpjegon pozicionin e Shqipërisë komuniste, në raport me konfliktin izraelito-palestinez, e cila u interpretua shtrembërisht si qortim i kryeministrit shqiptar ndaj Sekretarit Antony Blinken.

04. Raste tragjike


Përmbajtjet keqinformuese për raste tragjike (vdekje, vrasje), janë publikuar në media reale nga fushe e kronikës së zezë, të cilat janë vlerësuar si clickbait. Në portale informative u publikuan artikujt lidhur me raste tragjike (vdekje, vrasje), ngjarje këto të ndodhura jo në Kosovë, por që në titujt e këtyre artikujve nuk bëhej e ditur vendndodhja e ngjarjes.

Llojet e fushave

Në bazë të monitorimit dhe gjetjeve të përmbajtjet keqinformuese të trajtuara gjatë muajit maj del se publikues të ndryshëm (media reale, portale të dyshimta dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e sigurisë.

FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore




Fusha e sigurisë, gjatë muajit të kaluar (prill) ishte radhitur si e dyta me 28%, ndërsa gjatë këtij muaji (maj) radhitet si e para me 29%. Kryesisht përmbajtjet e paverifikuara, dezinformatat dhe lajmet e rreme janë publikuar nga kjo fushë duke bërë që siguria të dominojë sa i përket fushave. Në fushën e sigurisë u keqinformua për tema si, armatosja e FSK-së, vendbanimet me shumicë serbe, konflikti Izrael-Hamas, veriu, armatosja e Policisë së Kosovës, etj. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar, teori konspirative dhe lajm i rremë të cilat u publikuan kryesisht në media sociale.

Siguria pasohet nga fusha e politikës, e cila gjatë muajit të kaluar (prill) ishte radhitur si e para me 29%, gjatë muajit maj keqinformatat nga kjo fushë kanë pësuar rënie prej 1% duke bërë që kjo fushë të radhitet si e dyta me 28%. Ndërsa, sa u përket temave politike, kemi shumëllojshmëri përfshirë këtu, masat e BE-së ndaj Kosovës, njohja e Kosovës, dialogu Kosovë-Serbi etj. Edhe keqinformatat nga fusha e politikës kryesisht janë vlerësuar si dezinformatat e mashtrim dhe janë publikuar në media sociale dhe media reale.

Keqinformatat në tema sociale, kanë pësuar rënie prej 6% krahasuar me muajin paraprak, duke bërë që kjo fushë të radhitet e treta. Në kuadër të temave sociale dominojnë përmbajtje mashtruese për dhënie kredish, produkte për të cilat pretendohet se shërojnë sëmundje të caktuara, çmim të bukës, mundësi punësimi etj. Këto përmbajtje keqinformuese kryesisht janë vlerësuar si mashtrim dhe dezinformatë të cilat janë publikuar në media sociale.

Në vendin e katërt radhiten keqinformatat nga fusha e sportit. Këto përmbajtje u publikuan në media reale dhe media sociale, të cilat u vlerësuan si kryesisht përmbajtje mashtruese dhe dezinformatë.



79% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë nga fusha e sociale, politikës dhe sigurisë.


Llojet e publikuesve

4

Siç ndodhi në muajin e kaluar (prill), kur dominuan keqinformimet e publikuara në media sociale, edhe gjatë këtij muaji (maj) përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga faqe dhe llogari në media sociale vazhdojnë të dominojnë. Bazuar në gjetjet dhe trajtimet e përmbajtjeve keqinformuese, shihet një rritje e lehtë prej 1% të keqinformimeve të publikuara në media sociale krahasuar me muajin prill (nga 66% në prill 2024 në 67% në muajin maj 2024). Kjo mund të shpjegohet nga fakti se te gjitha përmbajtjet mashtruese dhe lajmet e rreme dhe një pjesë e konsiderueshme e dezinformatave dhe përmbajtjeve të paverifikuara janë publikuar në media sociale.

Keqinformimet e identifikuar dhe të trajtuara gjatë këtij muaji, të cilat janë publikuar në media reale (portale informative), kanë një përqindje të ngjashme me përmbajtjet e publikuara gjatë muajit të kaluar (prill). Kjo ndodh për faktin se pothuajse të gjitha përmbajtjet clickbait dhe një pjesë e dezinformatave, gabimeve dhe teorive konspirative janë publikuar pikërisht në media reale.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE



99% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media sociale (67%) dhe në mediat reale (32%).

Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Mostra e monitorimit dhe trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese nga platforma “hibrid.info” fokusohet në keqinformimet në gjuhën shqipe, të publikuara në media, portale të dyshimta, si dhe faqe dhe llogari në mediat sociale. Si rezultat, gjatë muajit maj 2024, publikimet në këtë gjuhë përbënin 86% të rasteve të trajtuara.

Gjatë këtij muaji, në kuadër të monitorimit, janë trajtuar gjithashtu dy raste keqinformimi në gjuhën angleze, të cilat ndërlidheshin me zhvillimet në Kosovë.

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët e tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet në gjuhën shqipe

Më shumë se gjysma e përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në gjuhën shqipe janë publikuar në media sociale (63%), ndërsa pjesa tjetër janë publikuar në mediat reale (22%) dhe portale të dyshimta (1%). Pothuajse të gjitha përmbajtjet mashtruese dhe një pjesë e konsiderueshme e dezinformatave, përmbajtjeve të paverifikuara dhe artikujve clickbait janë publikuar në media sociale. Ndërsa në media tradicionale janë publikuar pothuajse të gjithë artikujt clickbait, të gjitha gabimet dhe një pjesë e dezinformatave dhe përmbajtjeve të paverifikuara. Në media sociale dominojnë përmbajtjet keqinformuese nga fusha e sociale, sigurisë dhe politikës, ndërsa në mediat reale, sporti, politika dhe kronika e zezë janë fushat kryesore.

03. Publikimet në gjuhën angleze (për dhe rreth Kosovës)

Në gjuhën angleze u publikua pretendimi i paverifikuar për shkarkimin e Gabriel Escobar, zëvendëssekretarit të SHBA-vë, i cili u mohua nga Departamenti i Shtetit (DASH). Si dhe fotografia e Milan Radoiqiq të armatosur pranë bustit të “Car Lazarit” në veri u publikua në platformën X me pretendimin në anglisht se është realizuar në vitin 2023.

02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe (për dhe rreth Kosovës)

Pothuajse të gjitha përmbajtjet keqinformues në gjuhën serbe janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe dhe një pjesë në media sociale. Këto keqinformata ishin nga fusha e sigurisë dhe politikës të cilat u vlerësuan si teori konspirative dhe dezinformatë. Teori konspirative u vlerësuan incidentet në vendbanimet me shumicë serbe të cilat u interpretuan pa fakte si të motivuara etnikisht. Teori konspirative u vlerësua edhe pretendimi se Kurti ia ka ofruar Vatikanit tempujt serbë në Kosovë, si dhe ndërlidhja pa fakte e “Shqipërisë së Madhe” me idenë e pranimit të Kosovës në KIE nga ana e zëvendëskryeministrit të Serbisë, Aleksandar Vulin. Dezinformatë u vlerësuan pretendimi se Edi Rama ka mbajtur tubim në Greqi pa pëlqimin e autoriteteve greke dhe pretendimi se nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Saranda Bogujevci, është gruaja që shihet në një fotografi të shkrepur në vitin 2015, afër politikanit serb Savo Manojloviq, që është kandidat për kryetar në zgjedhjet e ardhshme lokale në Beograd.


Llojet e mediave sociale

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Gjatë muajit maj, 57% e përmbajtjeve keqinformuese në mediat sociale janë publikuar në Facebook, ndërsa 33% në TikTok, ndjekur nga X me 4% dhe Instagram, YouTube dhe Telegram me nga 2%. Ashtu si në muajin paraprak, keqinformimet e publikuara në Facebook kanë vazhduar të mbizotërojnë, duke pësuar një rënie prej 20% (nga 77% në prill 2024 në 57% në maj 2024).

Ndërkohë, keqinformimet e gjetura dhe të trajtuara në median sociale TikTok kanë shënuar një rritje prej 10% (nga 23% në prill 2024 në 33% në maj 2024). Ndërsa gjatë këtij muaji janë gjetur përmbajtje keqinformuese edhe në platformat e tjera si Instagram, X dhe YouTube.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Përmbajtjet keqinformuese të gjetura dhe trajtuara në mediat sociale për muajin maj 2024, më së shumti u publikuan nga faqe (41%) dhe llogari (8%) në Facebook, pasuar nga llogari në TikTok (33%) dhe llogari në platformën X (4%). Në muajin maj, 8% e keqinformatave ishin publikuar nga media në Facebook, 2% nga llogari në Instagram dhe Telegram dhe kanale në YouTube.



Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. Facebook

Socialja (31%), siguria (8%) dhe politika (6%) janë tri fushat kryesore, për të cilat u keqinformua gjatë këtij muaji në Facebook. Sa u përket kategorive, përmbajtjet mashtruese përbëjnë 16%, ndërsa përmbajtjet e paverifikuara dhe dezinformatat përbëjnë nga 14% secila. Në keqinformatat e publikuara në Facebook ka pasur shumëllojshmëri temash nga fushat e lartcekura, por që kanë dominuar lajmet e rreme dhe dezinformatat për çmimin e bukës, mashtrimet për dhënie kredish dhe përmbajtje të paverifikuara për konfliktin Izrael-Hamas.

03. X

Në platformën X është publikuar teoria konspirative me pretendimin e shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, për dëbimin dhe persekutimin e serbëve që jetojnë në Kosovë. Po ashtu dhe përmbajtja e paverifikuar, me pretendimin se fotoja e Radoiçiqit të armatosur pranë bustit të “Car Lazarit” në veri është e vitit 2023.

05. YouTube

Një kanal në YouTube ka publikuar një video-material nëpërmjet të cilit pretendohet se Kosova ka shprehur interesim për furnizim me armatim me pajisje ushtarake, e që është vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar.

02. TikTok

Lajmet e rreme (10%) dhe përmbajtjet mashtruese (10%) janë dy kategoritë kryesore që kanë dominuar gjatë monitorimit dhe gjetjeve të keqinformatave në TikTok për muajin maj. Siguria (18%), politika (12%) dhe sporti (2%) janë tri fushat për të cilat u keqinformua më së shumti në platformën TikTok. Armatosja e FSK-së dhe konflikti Izrael-Hamas janë dy temat që më së shumti u publikuan keqinformata për to, në mesin e shumë temave të tjera.

04. Instagram

Në një llogari në Instagram është publikuar një video-material me pretendimin se paraqet makineri që po marrin rërën nga shkretëtirat e Afrikës, duke e përhapur në atmosferë, për të ndotur ajrin, e që është vlerësuar si teori konspirative.

06. Telegram

Një llogari në gjuhën serbe në Telegram ka publikuar pretendimin e rrejshëm se Edi Rama ka mbajtur tubim në Greqi pa pëlqimin e autoriteteve greke, e që është vlerësuar si dezinformatë.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES



Bazuar në 73 përmbajtjet keqinformuese të gjetura dhe trajtuara gjatë muajit maj 2024, rezulton se në 11 prej tyre janë përmendur 6 institucione të ndryshme. Në mesin e këtyre institucioneve të përmendura mbizotërojnë Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë.


Forca e Sigurisë së Kosovës është përmendur në katër përmbajtje keqinformuese, konkretisht përmbajtje të paverifikuara dhe lajme të rreme të publikuara në media sociale. Ky institucion u përfol në pretendime të paverifikuara lidhur me furnizimin me artilleri të rëndë ushtarake.

Zyra për Kosovën në Qeverinë është përfshirë në katër përmbajtje keqinformuese në kontekst edhe me subjektin politik në Kosovë, Lista Serbe (Lista Srpska). Kjo Zyrë është përfolur në teoritë konspirative të publikuara nga mediat në gjuhën serbe, të cilat, duke iu referuar komunikatave të kësaj Zyre, disa zhvillime në vendbanimet me shumicë serbe në Kosovë i interpretonin si të motivuara etnikisht.

Policia e Kosovës (PK) është përfolur në dy keqinformata të publikuara në media sociale, ku nëpërmjet një fotografie të publikuar pretendohet rrejshëm se PK u pajis me 5000 armë të gjata, si dhe nëpërmjet një video-materiall pretendohet se paraqitet Policia e Kosovës në aksion, por kjo video ishte nga xhirimet e një seriali.

Të gjitha institucionet tjera janë përfolur nga një herë në përmbajtjet keqinformuese të gjetura dhe trajtuara. Institucioni i Qeverisë është përfolur në përmbajtjen mashtruese ku përmes një vegëze të dyshimtë mashtrohet se Qeveria jep energji diellore falas. Kryqi i kuq u përfol në përmbajtjen mashtruese me pretendimin se nga ky institucion i Kosovës dhurohet ndihmë për personat që vuajnë nga diabeti.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti (4 keqinformata) dhe ai i Shqipërisë, Edi Rama (3 keqinformata) janë dy figurat më të përfolura në 24 përmbajtjet keqinformuese ku janë përfolur personalitetet. Kurti është përfolur nga mediat në gjuhën serbe me pretendimin konspirativ se ia ka ofruar Vatikanit tempujt serbë në Kosovë, si dhe pretendimin e rremë për rritje në 80% të krimeve gjatë qeverisjes së Albin Kurtit. Kryeministri i Kosovës u përfol edhe në teorinë konspirative ku shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, pretendon pa fakte se Kurti po e kriminalizon pjesën veriore të vendit dhe po tenton të gjejë arsyetime për “dhunën fizike dhe ligjore” ndaj serbëve.

Kryeministri Rama, është përfolur në përmbajtjet keqinformuese përfshirë këtu deklaratën teksa shpjegon pozicionin e Shqipërisë komuniste, në raport me konfliktin izraelito-palestinez, e cila interpretohet shtrembërisht si qortim i kryeministrit shqiptar ndaj Sekretarit amerikan, Antony Blinken; pretendimin e rremë se Rama ka thënë se Serbia nuk do ta njohë kurrë Kosovën; si dhe dezinformatën në gjuhën serbe në Telegram se Edi Rama ka mbajtur tubim në Greqi pa pëlqimin e autoriteteve greke.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 maj 2024, në të cilën janë trajtuar 73 përmbajtje keqinformuese.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes një mujore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit maj 2024, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Në gjetjen dhe trajtimin e 73 përmbajtjeve gjatë muajit maj 2024, është evidentuar se përmbajtjet mashtruese dhe dezinformatat kanë qenë dy kategoritë kryesore të keqinformimit, secila me nga 19%. Kjo ka ndodhur për shkak të shumësisë së temave nga fusha e politikës dhe sociale që janë vlerësuar si dezinformata apo mashtrime. Këto kategori pasohen nga përmbajtjet e paverifikuara me 16%, clickbait me 12%, dhe teoritë konspirative e lajmet e rreme me nga 10%.

Pas zyrtarizimit të blerjes së dronëve “Bayraktar” nga Turqia, në media sociale filluan të qarkullojnë spekulime për furnizime të tjera me armatime, përfshirë artileri të rëndë si helikopterë, tanke dhe aeroplanë. Pretendimet e pabaza për furnizimin e FSK-së dominuan keqinformimet e muajit maj. Ndërkohë, konflikti Izrael-Hamas, i nisur më 7 tetor 2023, vazhdoi të jetë burim i rëndësishëm keqinformimi, me shumë përmbajtje të paverifikuara dhe dezinformata. Po ashtu, incidente në vendbanimet serbe në Kosovë u shfrytëzuan nga disa kanale për të krijuar teori konspirative.

Kryesisht përmbajtjet e paverifikuara, dezinformatat dhe lajmet e rreme për tema si, armatosja e FSK-së, vendbanimet me shumicë serbe, konflikti Izrael-Hamas, veriu, armatosja e Policisë së Kosovës, etj., ka bërë që fusha e sigurisë të prijë gjatë muajit maj me 29%. Siguria pasohet nga shumëllojshmëria e temave nga fusha e politikës, përfshirë masat e BE-së ndaj Kosovës, njohjen e Kosovës, dialogun Kosovë-Serbi, etj., e që janë vlerësuar si dezinformata dhe mashtrime dhe janë publikuar në media sociale dhe media tradicionale. Përmbajtjet mashtruese për dhënie kredish, produkte që pretendohet se shërojnë sëmundje të caktuara, çmimin e bukës, mundësi punësimi, etj., nga fusha sociale, janë vlerësuar kryesisht si mashtrime dhe dezinformata të publikuara në media sociale dhe janë radhitur si e treta në kategorizimin e fushave.

Ashtu si në muajin e kaluar (prill), keqinformimet e publikuara në media sociale kanë vazhduar të dominojnë edhe gjatë këtij muaji (maj), me rritje të lehtë prej 1% (nga 66% në prill 2024 në 67% në maj 2024). Kjo mund të shpjegohet nga fakti se të gjitha përmbajtjet mashtruese dhe lajmet e rreme, si dhe një pjesë e konsiderueshme e dezinformatave dhe përmbajtjeve të paverifikuara, janë publikuar në media sociale. Gjatë muajit maj, 57% e përmbajtjeve keqinformuese në mediat sociale janë publikuar në Facebook, ndërsa 33% në TikTok, dhe 10% në platformat tjera (X, Instagram, Youtube, Telegram).

Në 24 përmbajtjet keqinformuese ku janë përfolur personalitetet, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është përfolur në 4 raste, ndërsa ai i Shqipërisë, Edi Rama, në 3 raste. Kurti është akuzuar për pretendime të konspiruara dhe të rreme nga mediat në gjuhën serbe, duke përfshirë ofrimin e rremë të tempujve serbë në Kosovë te Vatikani dhe pretendimin se ai po e kriminalizon pjesën veriore të vendit. Ndërkohë, Rama është akuzuar për deklarata të rreme si dhe i është shtrembëruar një pozicion i tij lidhur me konfliktin izraelito-palestinez, e që u interpretua si qortim i kryeministrit shqiptar ndaj Sekretarit amerikan, Antony Blinken. Po ashtu u pretendua rrejshëm se Rama ka thënë Serbia nuk do ta njohë kurrë Kosovën; si dhe pati dezinformime në gjuhën serbe në Telegram se Edi Rama ka mbajtur tubim në Greqi pa pëlqimin e autoriteteve greke.

HIBRIDO.INFO